



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja (g) dhe 68 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, nenet 16, 61 paragrafi 1.7 dhe 71 paragrafi 4 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë merr:

V E N D I M

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT-PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE

Neni 1

Vëhen në diskutim publik:

1. Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjimore, Diskutimi publik sipas këtij paragrafi, zgjat 17 ditë përkatësisht prej datës 27.02.2024 deri më datë 14.03.2024, brenda së cilës Njësi për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Podujevës mund të organizoj diskutime/konsultime të ndryshme publike, kurse Debatit i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më datë 07.03.2024 duke filluar nga ora 13:00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 2

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë debateve publike, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; naime.podvorica@rks-gov.net; të cilat pastaj përcjellën në Njësi për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Podujevës, brenda periudhës së diskutimit publik.

Neni 3

Dokumentet sipas nenit 1, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe të njëjtat publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik) dhe në lokalitete të ndryshme aty ku Njësi përkatës i vlerëson të nevojshme.

Neni 4

Diskutimi/debatit publik zbatohet nga Njësi për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Podujevës në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raporteve nga diskutimet / debatet publike dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 5

Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas 7 ditë pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

U dërgohet:

Njësitit për të Drejtat e Njeriut.

QSHQ/Arkivi.

Nr. prot 02-016/09-0013625/24
Podujevë, datë, 27.02.2024

